

# LICENCË PËR GJENERIM TË ENERGJISË ELEKTRIKE (ME KUSHTE)

**DHËNË:**

***"KORPORATËS ENER GjETIKE TË KOSOVËS" SH.A***

***Divizioni i Gjenerimit, TC Kosova-A  
( "KEK" )***

**Numri i Regjistrimit: ZRRE\_Li\_05/06\_A**

## PASOYRA E PËRMBAJTJËS

	<b>Faqe</b>
<b>PJESA I    TERMAT E LICENCËS .....</b>	<b>4</b>
<b>PJESA II    KUSHTET E LICENCËS.....</b>	<b>5</b>
Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet .....	5
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Bizneset Gjeneruese.....	7
Neni 3: Ndalimi i Ndër-subvencioneve .....	8
Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit.....	8
Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit Elektrik dhe Kodin Matës.....	8
Neni 6: Marrëveshjet e Sigurisë.....	8
Neni 7: Dispeçingu Qendror .....	8
Neni 8: Shërbimet Ndihmëse .....	9
Neni 9: Caktimi i Operatorit .....	9
Neni 10:Rregullat e Tregut .....	10
Neni 11:Shëndeti dhe Siguria .....	10
Neni 12: Mjedisi. ....	10
Neni 13: Puna .....	11
Neni 14: Tjetërsimi dhe Heqja e Aseteve Relevante të të Licencuarit .....	11
Neni 15: Obligimi i Sigurimit .....	12
Neni 16: Ndryshimi në Kontrollin të Licencuarit .....	12
Neni 17: Shërbimet Publike të Detyrueshme.....	12
Neni 18: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së.....	12
Neni 19: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës.....	13
Neni 20: Taksat .....	14
Neni 21: Masat dhe Gjobat Administrative .....	14
Neni 22: Zgjidhja e Kontesteve .....	15

**Shtojca 1** Centralet gjeneruese për të cilat aplikohet Licenca (përshkrimi i objekteve – skicat dhe një renditje e njësisve gjeneruese që ofrojnë kapacitetin e tyre për furnizuesin publik me çmime të rregulluara, në përputhje me Nenin 8 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike )

**Shtojca 2** Përshkrimi i teknologjisë dhe kategorisë së karburantit të përdorur për gjenerimin e energjisë elektrike

**Shtojca 3** Përshkrimi i Grupit të të Licencuarit (aksionarët, anëtarët dhe vartësit e të Licencuarit – diagram, referencë ndaj disa përqindjeve të pjesëmarrjes aksionare dhe aktiviteteve të ushtruara prej secilës kompani).

## **PJESA I : TERMAT E LICENCËS**

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji (tani e tutje “ZRRE”)**, në ushtrim të autoritetit të dhënë prej Neneve 15.2 (a), 28.2 (a) dhe Nenit 37 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë (tani e tutje “Ligji”), Nenit 16.2 të Ligjit mbi Energjinë (Ligji 2004/8), dhe Nenit 5 dhe të Ligjit mbi Energjinë Elektrike, me anë të kësaj i lëshon **Korporatës Energjetike të Kosovës (“KEK”) SH.A,-Divisionit të Gjenerimit** (tani e tutje **"i Licencuari"**) **licencën për gjenerim të energjisë elektrike** në centralin gjenerues **Kosova A**, të përshkruar në Shtojcën 1, dhe me përshkrimin e njësisë, teknologjisë dhe kategorisë së karburantit të përdorur për gjenerim të energjisë elektrike në Shtojcën 2, gjatë periudhës së specifikuar në paragrafin 7, sipas Neneve dhe Kushteve të nxjerra në Pjesën II.
2. Kapaciteti nominal (i instaluar) i Njësive Gjeneruese të Kosovës A është: A1- 65 MW, A2 - 125 MW, A3 - 200 MW, A4 - 200 MW, A5 - 200 MW.
3. Kapaciteti operativ i Njësive Gjeneruese në Gjenerator/Transmision: njësia A1 është 35/25 MW, A2- 0 MW (dekomisionuar); A3 – 140/120 MW; A4 – 0; A5 – 120/100 MW.
4. I Licencuari është i detyruar të veproj në pajtueshmëri me Legjislacionin e aplikueshëm, Nenet dhe kushtet e përcaktuara në këtë licencë.
5. Nga i Licencuari kërkohet që t'i ofrojë furnizuesit publik energjinë elektrike me çmim të rregulluar të prodhuar nga centralet e veta elektrike, në rast se furnizuesi publik ka nevojë për energji elektrike.
6. Pas plotësimit të kriterëve të furnizimit publik përcaktuar në Pjesën I, Nenin 5, i Licencuari mund ta shes energjinë elektrike që e prodhon dhe kapacitetet e centralit të tij elektrik me çmime të negociuara lirshëm:
  - a) konsumatorëve të privilegjuar lokalë nëpërmes të kontratave duke u komunikuar shërbimet e tarifuara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Shpërndarjes, nëse Prodhuesi ka licencën për Furnizim/Tregti të lëshuar nga ZRRE.
  - b) tregtarëve lokalë nëpërmes të kontratave duke përdorur shërbimet e tarifuara të Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
  - c) konsumatorëve të privilegjuar apo tregtarëve të huaj nëse Prodhuesi ka licencën për Furnizim/Tregti të lëshuar nga ZRRE;
  - d) tregut të brendshëm apo regjional të shkëmbimit të energjisë elektrike;
  - e) furnizuesit publik në rast se kërkesat e konsumatorëve për energji janë rrit përtej kapacitetit total të kontraktuar.
7. I Licencuari do të drejtojë në mënyrë komerciale centralin e gjenerimit të energjisë elektrike, dhe më specifikisht:
  - a) të përdori në centralet e tyre energjetike ato burime kryesore të energjisë që i mendon si më të përshtatshme, me kusht që të jetë në pajtim me prodhimet, karakteristikat teknike, dhe kushtet mjedisore që përfshihen në licencat e tyre dhe në ligjet, rregulloret, kodet ose rregullat përkatëse;
  - b) të kyçë centralin elektrik me Sistemin e Transmisionit ose Shpërndarjes sipas

- kushteve të përcaktuara në kodet dhe rregullat përkatëse;
- c) të lidhë kontrata për shitjen e energjisë elektrike pas përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në Nenin 17 të kësaj licence;
  - d) të transmetojë energjinë e vet përmes Sistemit të Transmisionit dhe Shpërndarjes;
  - e) të marrë pagesën e duhur sipas kontratave.
8. Nenet dhe kushtet e kësaj licence u nënshtrohen ndryshimit ose përfundimit apo tërheqjes, në përputhje me termat e tyre dhe me Nenet 35,36,37 dhe 39 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
9. Kjo licencë do të hyjë në fuqi më 04\_Tetor 2006 dhe, përveçse në rast se tërhiqet, do të vazhdojë të jetë e vlefshme gjatë kohëzgjatjes teknike të pjesëve kryesore të centralit ekzistues që përdoren për kryerjen e aktiviteteve relevante dhe politikës amortizimit të të Licencuarit që është dërguar së bashku me aplikacionin, për një periudhë pesë (5) vjeçare, deri më \_04 Tetor 2011.

Në rast të ndryshimit në kapacitetin e njësive gjeneruese të Kosovës A, i Licencuari menjëherë do të njoftoj ZRRE-në.

Vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji më:\_\_\_\_\_.

Nënshkrimi (në emër të Bordit të ZRRE-së)\_\_\_\_\_ .

## **PJESA II: KUSHTET E LICENCËS**

### **Neni 1: Përkufizimet dhe Interpretimet**

1. Për qëllim të kësaj licence, termat dhe shprehjet e renditura me poshtë, do të kenë kuptimin vijues:

**"Anëtar"** nënkupton në marrëdhënie të drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo Kompani Aksionare apo vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një Kompanie Aksionare të të Licencuarit, në secilin rast brenda kuptimit të legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë;

**"Shërbime Ndhmëse"** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike dhe në Kodin e Rrjetit Elektrik.

**"Sistemi i Shpërndarjes"** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

**"Operatori i Sistemit të Shpërndarjes"** ka kuptimin e dhënë në Nenin 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

**"Ndërmarrje për energjinë elektrike"** ka kuptimin e dhënë sipas Nenit 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

**"Viti financiar"** është periudha prej 1 Janarit deri me 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

**"Biznes (veprimtari) gjenerimi "** është biznesi i licencuar i të Licencuarit dhe çdo anëtar i apo sipërmarrjeje të ngjashme, që merret me gjenerimin e energjisë elektrike ose sigurimin e Shërbimeve Ndhmëse<sup>1</sup>.

**"Njësi gjenerimi"** nënkupton çdo central apo aparat për gjenerimin e energjisë elektrike.

**"Kodi i Rrjetit Elektrik"** nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit sipas Ligjit të Energjisë Elektrike aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

**"Kompani aksionare "** nënkupton një kompani e definuar si e tillë, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë.

**"Legjislacioni"** nënkupton Ligjin mbi Energjinë (2004/8), Ligjin mbi Rregullatorin për Energji (2004/9), Ligjin mbi Energjinë Elektrike (2004/10) si dhe ç' do legjislacion primar apo sekondar që do të nxirët për të ekzekutuar legjislacionin primar e që rregullon sektorin e energjisë.

**"Operatori i Tregut"** nënkupton një person juridik që është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtisë së energjisë elektrike dhe marrëveshjet për pagesë midis gjeneruesve, furnizuesve dhe konsumatorëve.

**"Rregullat e Tregut"** nënkuptojnë grup rregullash të miratuara nga ZRRE që udhëheqin tregtinë e energjisë midis Operatorit të Tregut dhe ndërmarrjeve tjera të energjisë elektrike, si

dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit, me qëllim të mirëmbajtjes së balancës fizike të tregut Kjo përfshinë çdo marrëveshje kalimtare mbi tregtimin që do të mund të aprovohej nga ZRRE-ja.

**"Kodi Matës"** nënkupton grumbull rregullash teknike të lëshuara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit sipas Ligjit të Energjisë Elektrike aprovuar nga ZRRE-ja, sipas Nenit 15.2 (i) të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

**"Modifikim"** përfshin shtimin, ndryshimin dhe zëvendësimin, dhe shprehjet e përafërta që do të shpjegohen në përputhje me rrethanat.

**"Marrëveshje për Blerje të Energjisë"** nënkupton çdo marrëveshje që i referohet Nenit 21.3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

**"Vartës"** nënkupton çdo kompani në pronësi apo e kontrolluar nga një kompani tjetër, e që definohet sipas legjislacionit të aplikueshëm në Kosovë.

**"Furnizues"** nënkupton person juridik të licencuar që të shes energjinë elektrike konsumatorëve të privilegjuar në Kosovë, sipas Nenit 22 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

**"Sistemi i Transmisionit"** ka kuptimin e dhënë sipas Nenit 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike,.

**"Operatori i Sistemit të Transmisionit"** ka kuptimin e dhënë sipas Nenit 3 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike.

2. Termat e përdorur në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termat e përdorur në Legjislacion.
3. Duke iu referuar paragrafit 2, çdo modifikim ose ri-dekretim i legjislacionit, pas datës kur kjo licence hyn në fuqi, do të aplikohet.
4. Përveç nëse specifikohet ndryshe:
  - (a) çdo referencë në një Nen të numëruar ose në një Shtojcë të numëruar, është respektivisht një referencë në Nenin apo Shtojcën që mban atë numër në këtë licencë;
  - (b) çdo reference në një paragraf të numëruar, është një reference në paragrafin që mban të njëjtin numër në Nenin ose në Shtojcën ku shfaqet referenca.
5. Titulli ose tema e ndonjë Pjese, Neni, Shtojce ose paragrafi nuk do të ndikojë në kuptimin e saj.
6. Kur të Licencuarit i imponohet për të kryer një detyrim brenda një afati të specifikuar, ai detyrim duhet të vazhdojë të jetë detyrues dhe në fuqi edhe pas atij afati kohor, pa marrë parasysh masat administrative dhe gjobat që mund të vendosen kundër të Licencuarit, nëse i Licencuari nuk arrin të kryejë aktivitetin e duhur brenda afatit kohor.
7. Dispozitat e paragrafit 6 do të aplikohen në çdo dokument që do të paraqitet ose, udhëzimi, njoftimi dhe shërbimi që duhet të kryhet sipas kësaj licence dhe udhëzimeve të

lëshuara prej ZRRE-së.

## **Neni 2: Llogaritë e Ndara për Bizneset Gjeneruese**

### **Kushti 1**

Në pajtim me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë i Licencuari duhet të veproj në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e këtij Neni brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence.

1. I Licencuari do të përgatisë kontabilitetet vjetore rregullative në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, nxjerrë nga ZRRE-ja dhe do t'i dorëzojë ZRRE-së një kopje të kontabilitetit vjetor të revizionuar (audituar) përgatitur sa më shpejt që është e mundur, dhe i cili duhet të dorëzohet brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar (kontabiliteti).
2. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për Biznesin Gjenerues në tërësi, e cila kërkohet kohë pas kohe nga ZRRE-ja, dhe do t'i dorëzohet në formën dhe datën e specifikuar nga ZRRE-ja. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, që nxirren kohë pas kohe nga ZRRE-ja.
3. Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet ose udhëzimet që ZRRE-ja i njofton të Licencuarit sipas paragrafit 2, ndër të tjerash mund të:
  - a) specifikojnë formën e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, asetëve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë biznes tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis bizneseve gjenerues të konsoliduar dhe ndonjë biznesi tjetër;
  - b) të specifikojë natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuar të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuar;
  - c) të specifikojë parimet e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshojë bazat e tarifimit, shpërndarjes ose alokimit që janë përdorur në vitin financiar paraprak, përveçse nëse ZRRE-ja nxjerr më parë udhëzimet për qëllimet e këtij Neni, ku i drejtohet të Licencuarit që të ndryshojë këto baza sipas mënyrës së përcaktuar në udhëzim, ose nëse ZRRE-ja jep paraprakisht aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo urdhëresë të lëshuar nga ZRRE-ja e për qëllim të këtij Neni.

### **Neni 3. Ndalimi i Ndër-subvencioneve**

1. I Licencuari do të sigurojë që bizneset gjeneruese nuk do të japin dhe as nuk do të marrin ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (drejtpërdrejtë apo të tërthortë) prej njeri-tjetrit apo ndonjë biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartësi (ortaku) apo ndërmarrjeje të ngjashme (partnere) të të Licencuarit dhe/ose nga ndonjë person tjetër.

### **Neni 4: Ndalimi i Diskriminimit**

1. I Licencuari në ç' do kohë do t'i zbuloj ZRRE-së rrethanat e shitjes ndaj këtyre blerësve, përfshirë (pa kufizim) vëllimin, faktorët e ngarkesës, kushtet e ndërprerjes, afatet dhe kohëzgjatjen e marrëveshjeve përkatëse.
2. Duke iu referuar paragrafit 2, i Licencuari do të dorëzojë në ZRRE informacione rreth:
  - a) sigurimit të energjisë elektrike për çdo furnizues publik; dhe
  - b) sigurimit të energjisë elektrike përmes marrëveshjes për blerjen e energjisë/kontratave me konsumator të privilegjuar.
3. Duke ju Referuar paragrafit 3, sigurimi i energjisë elektrike për çdo person gjithashtu do të përfshijnë sigurimin e kapacitetit në dispozicion të çdo njësie gjenerimi.

### **Neni 5: Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit Elektrik dhe Kodin Matës**

#### **Kushti 2:**

Në pajtim me Nenin 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, pas konsultimit me të Licencuarin, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe Operatorin e Sistemit të Transmisionit, ZRRE-ja do të jap të Licencuarit një orar kohorë për të implementuar këtë Nen. Orari i tillë kohor mund të zbatohet dhe të ketë shtrirje në ato pjesë të Kodeve siç precizohet në atë orar.

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit Elektrik dhe Kodit Matës, për aq sa janë të zbatueshëm.

### **Neni 6: Marrëveshjet e Sigurisë**

1. I licencuari do të përgatisë planin për rezervat e karburantit, sipas Nenit 11 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike si dhe me legjislacionin sekondar përkatëse lëshuar nga Ministria e Energjisë dhe Minierave.
2. I licencuari do të veproj në përputhje me çdo dispozitë që përcakton llojin dhe masën e minimumit të rezervës së karburanteve, ose kapacitetin specifik për rezerva, si dhe legjislacionit sekondar përkatës të Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe Kodeve përkatëse.

### **Neni 7: Dispeçingu Qendror**

1. I Licencuari do të paraqesë të gjithë njësitë e gjenerimit në dispozicion në Dispeçingun Qendror nga Operatori i Sistemit të Transmisionit, kur Dispeçingu Qendror kërkohet sipas

Kodit të Rrjetit Elektrik dhe Rregullave e Tregut dhe aq sa janë të aplikueshme.

2. I Licencuari, do t'i sigurojë Operatorit të Sistemit të Transmisionit, të gjitha informacionet e kërkuara në mënyrë të arsyeshme prej tij, në mënyrë që ta aftësojë për të vënë në funksion sistemin e Dispečingut Qendror, sa herë dhe në mënyrën siç parashihet me Kodin e Rrjetit Elektrik.
3. Në këtë Nen:

*"Në dispozicion"* në lidhje me çdo njësi gjenerimi nënkupton një njësi gjenerimi i cili është në dispozicion në përputhje me Kodin e Rrjetit Elektrik.

*"Dispečingu Qendror"* nënkupton procesin e planifikimit dhe lëshimit të udhëzimeve direkte për shpërndarjen e njësive të gjenerimit në dispozicion prej Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

### **Neni 8: Shërbimet Ndhmëse**

1. I Licencuari kohë pas kohe, do të ofrojë kushte për furnizimin e Shërbimeve Ndhmëse prej çdo njësie gjenerimi, në rast se kjo kërkohet prej Operatorit të Sistemit të Transmisionit, në përputhje me Kodin e Rrjetit Elektrik.
2. Kur kushtet e ofruara nga i Licencuari janë të pranueshme për Operatorin e Sistemit të Transmisionit, atëherë ata do të lidhin marrëveshje.
3. Nëse Operatori i Sistemit të Transmisionit vë në pyetje kushtet e ofruara nga i Licencuari sipas paragrafit 1, ZRRE-ja do të përcaktojë çdo kusht të marrëveshjes që është në mospërputhje e sipas Rregullit mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
4. Nëse Operatori i Sistemit të Transmisionit dëshiron të procedojë në bazë të kushteve të përcaktuar nga ZRRE-ja, i Licencuari do të hyje menjëherë në këtë marrëveshje dhe do ta zbatojë atë në përputhje me kushtet e saj.
5. Duke ju referuar paragrafit 1, i Licencuari, pas kërkesës së ZRRE-së, do ti siguroj ZRRE-së raportin me detajet si në vijim:
  - a) çmimet e ofruara për sigurimin e Shërbimeve Ndhmëse nga ç' do njësi gjeneruese të të Licencuarit; dhe
  - b) detajet lidhur me koston e të Licencuarit për sigurimin e Shërbimeve Ndhmëse të tilla.

### **Neni 9: Caktimi i Operatorit**

1. I Licencuari do të emëroj një individ(ët) të kualifikuar dhe me përvojë përkatëse që të jetë përgjegjës për operimin e çdo njësie gjeneruese të përfshirë në licencë. Para emërimit të ndonjë individi të tillë i Licencuari duhet të siguroj miratimin me shkrim nga ZRRE-ja.
2. Nëse ndonjë operatorë nuk është më kompetent që të ushtroj atë funksion, ZRRE-ja me njoftim me shkrim dhënë të Licencuarit, mundet ta tërheq miratimin e atij personi.

3. Duke iu referuar paragrafit 2, ZRRE-ja do të përcaktojë se cilët kritere do të merren parasysh në shqyrtimin e kompetencës, në përputhje me kriteret që lidhen me njohuritë dhe aftësitë profesionale, përvojën, si dhe me kriteret që lidhen me kërkesën për mbrojtje dhe sigurim të gjenerimit.

## **Neni 10: Rregullat e Tregut**

### **Kushti 3**

ZRRE-ja mund të nxjerr urdhëresa me të cilat liron të Licencuarin nga obligimet e parapara në paragrafin 1,2 dhe 3 më poshtë sa i përket pjesëve të Rregullave të Tregut në atë masë si do të precizohet në ato urdhëresa.

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me Rregullat e Tregut derisa ato janë të aplikueshme për të.
2. I Licencuari do ti themeloj çmimet e rregulluara të biznesit gjenerues në përputhje me Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike të lëshuar nga ZRRE dhe modelin e tregut të caktuar në Rregullat e Tregut.
3. Brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga lëshimi i kësaj licence, i Licencuari do të përpiloj programin e pajtueshmërisë, i cili përcakton masat që duhet ndërmarr për të siguruar sjellje jo-diskriminuese në relacion me pjesëmarrjen e të Licencuarit në Rregullat e Tregut dhe të siguroj monitorimin adekuat të sjelljeve të tilla.

## **Neni 11: Shëndeti dhe Siguria**

1. I Licencuari duhet ti ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për ti mbrojtur personat dhe pronën nga lëndimet dhe dëmtimet që mund të shkaktohen nga ana e tij gjatë ushtrimit të aktiviteteve të licencuara.
2. I Licencuari do të sigurojë që ekspertët e pavarur, emërimi i të cilëve është miratuar nga ZRRE-ja, të bëjnë kontrollim teknik dhe të sigurisë të kapaciteteve gjeneruese në baza vjetore.
3. I Licencuari duhet ti siguroj ZRRE-së rezultatet e kontrollit të tillë brenda tre (3) muajsh nga kompletimi i tyre.

## **Neni 12: Mjedisi**

### **Kushti 4**

Me qëllim të përmbushjes së këtij Neni, sipas Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ZRRE-ja mund ti jap të Licencuarit një udhëzim me orar kohorë specifik të implementimit.

1. Brenda njëzetekatër (24) muajsh nga lëshimi i kësaj licence, i Licencuari do ti dërgoi ZRRE-së lejen për mbrojtjen e mjedisit të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. I Licencuari duhet të veproj në pajtueshmëri me legjislacionin

mbi mjedisin të aplikueshëm në Kosovë që është në fuqi apo që do të hyj në fuqi në të ardhmen.

2. Jo më larg se data e përcaktuar nga ZRRE-ja, i Licencuari do të përgatisë dhe kohë pas kohe do të modifikoj, politikë me shkrim ku përcaktohet mënyra me të cilën i Licencuari propozon të pajtohet me detyrimet e veta, në përputhje me legjislacionin për mjedisin të aplikueshëm në Kosovë.
3. I Licencuari do t'i raportojë ZRRE-së çdo vit, mbi aktivitetin e tij mjedisor.
4. Për qëllimet e kësaj licence:

**“Legjislacion mbi mjedisin”** nënkupton legjislacionin që ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit, përfshirë mbrojtjen e shëndetit njerëzor, florës dhe faunës, dhe ekosistemet dhe do të përfshijë por nuk do të kufizohet vetëm me Ligjin mbi Mbrojtjen e Mjedisit dhe gjithë legjislacionet përkatëse dhe “Acquis Communautaire” siç është dhënë në Kapitullin III të Marrëveshjes për themelimin e Komunitetit të Energjisë.

### **Neni 13: Puna**

I Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me të gjithë Legjislacionin e aplikueshëm lidhur me punën dhe sigurinë në punë që është në fuqi apo që do të hyjë në fuqi në të ardhmen.

### **Neni 14: Tjetërsimi dhe Heqja e Aseteve Relevante të të Licencuarit**

1. I Licencuari nuk do të tjetërsoj apo braktis kontrollin operacional mbi çdo aset relevant poqëse tjetërsimi apo braktisja do të ndikojë në aftësinë për të kryer obligimet apo nëse asetit ka vlerën e zëvendësimit mbi 100,000.00 Euro.
2. Në rastet kur i Licencuari kërkon të tjetërsoj disa asete të pronësisë materiale që janë pronë e tij ose të përdorura prej tij, si dhe burime të tjera të përdorura për të kryer aktivitetin e licencuar, i Licencuari është i detyruar të njoftojë me shkrim ZRRE-në. I Licencuari mund të realizojë tjetërsimin e aseteve pas aprovimit me shkrim nga ZRRE-ja.
3. E njëjta si në paragrafin 1 aplikohet ndaj heqjes të aseteve ose burimeve të tjera të shfrytëzuara për të kryer aktivitetin e licencuar.
4. Për qëllimet e këtij Neni:

**“Tjetërsimi”** nënkupton çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkim, kufizimin mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor), dhënie, ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejin e ndonjë ngarkese ndaj një Biznesi tjetër të të Licencuarit dhe/ose pale të tretë, dhe “tjetërsimi” do të interpretohet në përputhje me rrethanat.

**“Aset Relevant”** konsiderohet të jetë çdo pajisje e luajtshme ose e paluajtshme me vlerë zëvendësimi mbi 100,000.00 Euro.

## **Neni 15: Obligimi i Sigurimit**

### **Kushti 5**

I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me kërkesat e caktuara në paragrafin 1 brenda dymbëdhjetë (12) muajsh nga data e lëshimit të kësaj licence.

1. I Licencuari do të lidhë dhe mbajë në fuqi kontrata sigurimi lidhur me veprimtaritë e gjenerimit duke siguruar rreziqet që ZRRE-ja mund ti adresoj kohë pas kohe. Kontratat e tilla do ti dërgohen ZRRE-së për rishikim ç' do vit..

## **Neni 16: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit**

I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll të tij së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE –ja nuk e aprovon atë.

## **Neni 17: Shërbimet Publike të Detyrueshme**

1. Nga i Licencuari kërkohet që energjinë elektrike të prodhuar nga centrali i tij elektrik t'ia ofroj furnizuesit publik me çmime të rregulluara nëse furnizuesi publik ka nevojë për energji elektrike, e në përputhje me Nenin 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

## **Neni 18: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së**

1. I Licencuari do t'i dorëzojë informacionin ZRRE-së, në mënyrën dhe në afatet siç kërkohet nga ZRRE-ja, si dhe do t'i sigurojë dhe japë ato raporte që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë të nevojshme duke marrë parasysh çdo Nen apo Kusht të kësaj licence, ose siç mund të kërkojë për qëllimin e kryerjes së funksioneve që i janë caktuar ose transferuar atij sipas Nenit 29 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë apo legjislacionit tjetër të aplikueshëm.
2. Informata do të përgatitet në nivel të revizionimit (auditivit) ashtu siç mund të kërkohet nga ZRRE-ja kohë pas kohe.
3. Autoriteti i ZRRE-së për të kërkuar informacion sipas paragrafit 1 nuk limiton kompetencat e ZRRE-së që të kërkojë edhe informacionin që konsiderohet konfidencial sipas çdo Neni apo kushti tjetër të kësaj Licence ose sipas Legjislacionit të aplikueshëm.
4. Nëse i Licencuari kërkon që një informatë e caktuar të konsiderohet si konfidenciale, bazuar në Rregullin për Konfidencialitetin e Informatave është obligim i tij që të shënoj atë informatë si konfidenciale dhe t'ia arsyetoj ZRRE-së kërkesën e tij .
5. I Licencuari do të themeloj lidhje komunikimi me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut duke caktuar personin i cili për të do të komunikoj me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut. Adresa, numri i telefonit, faksit ose adresa elektronike e atij personi do t'i dërgohen Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut.
6. I Licencuari do ti dërgoj ZRRE-së çdo kontratë të nënshkruar në lidhje me tregtinë ndër-

kufitare me energji elektrike, kontratat për furnizim, marrëveshjet për blerje të energjisë elektrike dhe çdo kontratë të nënshkruar në pajtim me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë Elektrike.

7. I Licencuari do ti dërgoj ZRRE-së raportet tremujore dhe vjetore mbi veprimtarinë gjeneruese dhe pajtueshmërinë me Nenet dhe kushtet e licencës e që është në përputhje me Doracakun e Raportimit të nxjerr nga ZRRE-ja.
8. I Licencuari do ti dërgoj ZRRE-së detalet e çdo ndryshimi të informatës së dërguar me aplikacion për këtë licencë.
9. Në këtë Nen:

*"Informacioni"* nënkupton materialin që në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

#### **Neni 19: Arsyet për Përfundimin, Tërheqjen dhe Modifikimin e Licencës**

1. ZRRE-ja mund të përfundojë këtë licencë sipas Nenit 39 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë nëse obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të vijnë në pozitë të pa lakmueshëm për shkak të përfundimit. Përfundimi i licencës do të ndërmerret në rast të:
  - a) skadimit të afatit të licencës;
  - b) me kërkesën e pranuar nga ndërmarrja e licencuar e energjisë lidhur me licencën e tij;
  - c) shpërbërjen e personit juridik që mban licencën;
  - d) shkatërrimin e stabilimentit energjetik;
  - e) pas vendimit të gjykatës me të cilin shpall falimentimin e të Licencuarit apo vendimit të gjykatës për përfundimin e aktiviteteve gjeneruese për shkak të shpalljes së likuiditetit të të Licencuarit;
  - f) nëse aktiviteti i licencuar për gjenerim nuk është ushtruar më shumë se gjashtë (6) muaj, përpos kur ndërprerja e aktivitetit është bërë me miratimin e ZRRE-së;
  - g) nëse janë plotësuar kushtet nga dispozitat e Nenit 44 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
  - h) nëse ndonjë shumë e caktuar lidhur me tarifën nuk është paguar tridhjetë (30) ditë nga data e caktuar dhe ka mbetur e papaguar edhe për një periudhë tjetër prej tridhjetë (30) ditësh pas vërejtjes me shkrim të dhënë nga ZRRE-ja në lidhje me vonesën e pagesës me kusht që asi vërejtje nuk do të lëshohet më herët se data kur shumata është dashur të paguhet.
2. ZRRE-ja mund të tërheqë këtë licencë në rastet e paraqitura më poshtë si është përcaktuar në Nenin 44.5 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, në rast se këto detyrime të të Licencuarit do të kryhen prej një të Licencuari tjetër ose që konsumatorët nuk do të vijnë në pozitë të disfavorshëm nga kjo tërheqje:
  - a) i Licencuari nuk i plotëson kushtet e Neneve apo obligimet nga licenca apo edhe i shkel ato, dhe se ai mosplotësim apo shkelje nuk është ndrequr brenda afatit të

- caktuar nga ZRRE-ja, apo ka dëmtuar seriozisht kualitetin, sigurinë dhe seriozitetin e shërbimit që i Licencuari ishte i obliguar ta ofroj;
- b) nëse gjatë monitorimit të licencës nga ZRRE-ja gjenden dështime në përmbushjen e kërkesave administrative dhe se ato dështime nuk janë eliminuar brenda afatit të caktuar nga ZRRE;
  - c) i Licencuari prezanton informata materiale false në bazë të të cilave është dhënë licenca.
3. Në pajtim me Nenin 35 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ZRRE mund ta modifikoj këtë licencë në rastet si në vijim:
- a) me kërkesën e të Licencuarit;
  - b) rritjen/zvogëlimin e kapaciteteve gjeneruese;
  - c) kur kërkohet të mbrohet sistemi energjetik në Kosovë, në lidhje me sigurinë e furnizimit, sigurinë kombëtare, sigurinë e jetës dhe shëndetit të qytetarëve, ose mbrojtjen e ambientit;
  - d) në mënyrë që t'u plotësohen kërkesat e reja të paraqitura në marrëveshjet ndërkombëtare, ligjet vendore, rregulloret dhe legjislacionin tjetër të aplikueshëm;
  - e) si sanksion për shkeljen e termeve dhe kushteve të licencës, sipas Nenit 44 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

#### **Neni 20: Taksat**

1. I Licencuari do t'i paguajë ZRRE-së çdo taksë fillestare dhe vjetore të caktuar sipas Pasqyrës së Taksave, të nxjerrë dhe miratuar nga ZRRE-ja.
2. Taksa fillestare është përcaktuar në bazë të kapacitetit që tejkalon 50 MW por është më i vogël se 400 MW e sipas Pjesës I, Nenit 3 të kësaj licence dhe bazuar në Shtojcën A të Pasqyrës së Taksave.
3. Mospagesa e taksave me datat e caktuara në Pasqyrën e Taksave mund të qoj deri te tërheqja e licencës.

#### **Neni 21: Masat dhe Gjobat Administrative**

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit, Neneve apo kushteve të kësaj Licence apo ndonjërin prej instruksioneve të ZRRE-së dhënë të Licencuarit, ZRRE-ja ka kompetenca që sipas Nenit 56.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit për Masat dhe Gjobat Administrative ose ta parandaloj të Licencuarin që ti përsëris veprimet ilegale apo në rast se veprimi është ndaluar, ZRRE mund të lëshoj vendim me të cilin kërkohet që të ndërmerren veprime konkrete apo ta ngarkoj me gjoba administrative të Licencuarin dhe/apo anëtarin e Bordit të Drejtorëve dhe/apo ekzekutivin e saj.
2. Para se të jepet gjoba ZRRE do ti lëshoj të Licencuarit një njoftim mbi shkeljet e bëra dhe do ti ofroj mundësi që brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga data e pranimit të njoftimit të përgjigjet me shkrim për të përmirësuar shkeljen.
3. Gjoba do ti caktohet të Licencuarit në pajtim me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullit për Gjobat dhe Masat Administrative.

4. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Rregullin për Gjobat dhe Masat Administrative. Sidoqoftë nëse gjoba nga paragrafi 3 i ngarkohet të Licencuarit ajo nuk mund ta tejkaloj 15% e të ardhurave nga veprimtaria e ushtruar sipas kësaj licence në vitin financiar paraprak.
5. Nëse gjoba nga paragrafi 3 i është ngarkuar anëtarit të Bordit të Drejtorëve apo ekzekutivit të të Licencuarit ajo nuk duhet të tejkaloj 300% e pagës mujore që ai person ka pranuar nga i Licencuari.
6. Në rast të përsëritjes së shkeljes, gjoba e ngarkuar mund të jetë tre (3) herë më e lartë se shumata e autorizuar me paragrafin 4 apo 5.
7. Gjatë ngarkimit të gjobës, në pajtim me këtë Nen, ZRRE do ta ketë parasysh shkallën e dëmtimit të shoqërisë nga ai veprim, sjelljet e përparshme të të Licencuarit ose të personit si dhe gjendjen financiare të Licencuarit dhe personit.
8. Nëse gjoba e ngarkuar nga ZRRE-ja nuk është paguar, ZRRE do të inicioj procedurën gjyqësore për të marr gjobën si borxh civil.

#### **Neni 22: Zgjidhja e Kontesteve**

1. Çdo kontest që paraqitet apo është e lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në pajtim me Rregullin mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të miratuar nga ZRRE.
2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me modifikimin, tërheqjen apo përfundimin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të apelojnë nga i Licencuari në Gjykatën kompetente.